


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2021

Tiranë, më 17 Mars 2021: Në Shkurt 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 0,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 4,4 %, në krahasim me Janar 2021. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 0,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 15,0 %, në krahasim me Janar 2021. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u rritur me 2,7 %, krahasuar me Shkurt 2020 dhe me 26,7 %, në krahasim me Janar 2021.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave, Shkurt 2021 (%)




Në dymujorin e parë 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 49 mld lekë, duke u rritur me 1,0 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 98 mld lekë, duke u rritur me 4,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 49 mld lekë, duke u rritur me 7,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shkurt 2021, rënia e eksporteve prej 0,9 %, krahasuar me Shkurt 2020, është ndikuar nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -7,6 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,5 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me + 4,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2021 (p.p)




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë rritur me 1,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,6 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +2,1 pikë përqindje, “Makineri, paisje, pjesë këmbimi” me +0,8 pikë përqindje. Në uljen vjetore të eksporteve kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -4,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,8 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shkurt 2021, rritja e importeve prej 0,9 %, krahasuar me Shkurt 2020, është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me +4,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,9 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,6 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -1,0 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2021 (p.p)



Si dymujor, importet janë rritur me 4,3 %, krahasuar me dymujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +2,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,4 pikë përqindje. Në uljen vjetore të importeve kanë ndikuar grupet: “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,7 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2020 janë: Kosova (29,0 %), Greqia (23,2 %) dhe Kina (9,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (11,1 %), Spanja (45,6 %) dhe Gjermania (26,4 %).

Gjatë këtij dymujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (7,4 %), Greqia (12,3 %) dhe Kina (46,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (3,7 %), Spanja (25,4 %) dhe Gjermania (26,1 %).

Në muajin Shkurt 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2020 janë: Italia (7,2 %), Turqia (11,6 %) dhe Gjermania (12,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Greqia (4,2 %), Polonia (4,3 %) dhe Spanja (33,9 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (9,8 %), Turqia (6,8 %) dhe Kina (9,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Greqia (8,3 %), Zvicra (6,8 %) dhe Rusia (52,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 63,5 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,3 %), Turqia (7,5 %), Greqia (7,2 %) dhe Gjermania (6,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin e parë 2021, me vendet e BE-së zënë 63,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,7 %), Turqia (7,4 %), Kina (7,3 %) dhe Greqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	Janar – Shkurt 19	44	-6,3	92	1,3	-47	48,4
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	Janar – Shkurt 20	48	8,0	94	1,9	-46	51,3
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	Janar – Shkurt21	49	1,0	98	4,3	-49	49,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Jan. - Shk. 2020	Jan. - Shk. 2021	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Jan. - Shk. 2020	Jan. - Shk. 2021
Vendet e BE-së	19.971	18.224	38.808	37.462	29.283	30.662	52.324	55.218
Austri	129	164	295	295	401	409	684	804
Gjermani	1.321	973	2.787	2.060	3.761	4.243	6.906	7.371
Greqi	1.111	1.369	2.216	2.488	4.374	4.191	8.722	8.000
Itali	12.536	11.143	23.930	23.045	12.781	13.708	22.614	24.826
Spanjë	2.762	1.502	5.252	3.917	1.056	698	1.771	1.174
Kroaci	177	236	358	526	354	305	793	582
Të tjera të BE-së	1.934	2.837	3.970	5.131	6.556	7.108	10.834	12.461
Mbretëri e Bashkuar	49	26	131	75	298	389	746	651
Kinë	710	778	1.012	1.482	4.203	4.235	8.325	9.123
Kosovë	1.660	2.141	3.244	3.485	584	619	1.048	1.159
Maqedonia e Veriut	597	496	1.091	909	682	754	1.285	1.310
Rusi	-	-	6	-	1.569	684	2.927	1.382
SHBA	281	425	461	892	843	1.516	1.669	2.287
Turqi	244	452	441	1.027	4.781	5.336	9.103	9.719
Ukrainë	63	50	67	69	174	380	656	532
Zvicër	77	213	169	234	1.930	627	2.272	2.117
Të tjera	1.360	1.967	2.592	2.873	7.416	7.044	13.319	14.169
Gjithsej	25.009	24.772	48.021	48.508	51.762	52.247	93.673	97.667

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Jan. - Shk. 2020	Jan. - Shk. 2021	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Jan. - Shk. 2020	Jan. - Shk. 2021
Gjithsej	25.009	24.772	48.021	48.508	51.762	52.247	93.673	97.667
Ushqime. pije. duhan	2.249	2.720	4.328	5.316	8.211	8.586	15.803	15.713
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4.668	4.654	8.627	8.228	5.796	3.901	10.479	9.864
Produkte kimike dhe plastike	613	700	1.150	1.320	7.590	8.595	12.634	14.599
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	263	148	471	290	1.357	860	2.323	1.561
Prodhime druri dhe letre	763	660	1.539	1.277	2.118	1.796	3.637	3.253
Tekstile dhe këpucë	10.270	8.369	20.022	17.668	6.887	6.076	12.661	11.959
Materiale ndërtimi dhe metale	3.434	4.650	6.709	8.899	7.594	7.256	12.975	13.311
Makinieri. pajisje dhe pj. këmb.	1.957	2.017	3.665	4.026	10.415	12.480	19.790	23.013
Të tjera	793	856	1.509	1.483	1.795	2.698	3.371	4.393

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	23.930	23.045	5.252	3.917	3.244	3.485	2.216	2.488
Ushqim. pije duhan	1.390	1.602	152	269	397	472	438	579
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	250	240	4.688	3.531	336	909	165	369
Produkte kimike dhe plastike	369	341	44	1	287	357	75	109
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	374	258	44	0	2	1	9	2
Prodhime druri dhe letre	1.064	842	1	1	105	112	222	157
Tekstile dhe këpucë	15.330	14.139	270	83	14	26	995	900
Materiale ndërtimi dhe metale	2.286	2.927	38	19	1.675	1.210	229	273
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	2.193	1.943	5	11	164	211	17	28
Të tjera	673	752	10	1	266	188	66	71

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	22.614	24.826	9.103	9.719	8.325	9.123	8.722	8.000
Ushqim. pije duhan	2.795	3.100	862	850	112	141	2.433	2.244
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	501	1.787	287	177	3	0	2.014	1.594
Produkte kimike dhe plastike	2.541	3.204	1.052	1.187	864	1.017	1.215	1.118
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.926	1.263	44	45	102	83	6	6
Prodhime druri dhe letre	1.028	819	452	495	167	159	519	464
Tekstile dhe këpucë	5.677	5.579	2.665	2.362	1.601	1.620	677	465
Materiale ndërtimi dhe metale	2.864	3.194	2.117	2.346	1.304	944	1.317	1.404
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	4.529	5.141	1.410	1.405	3.362	4.223	334	392
Të tjera	754	740	215	852	810	936	207	313

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri